



**REPUBLIKA E MAQEDONISË VERIORE**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr. 03-213**  
**16.06.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (10 nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (5) të Ligjit për media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13 dhe 13/14 ), pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark. nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10 – 1941/1 datë 27.4.2023 dhe Konkluzioni ark.nr.02-2414/7, datë 15.6.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 19-të mbajtur më 15.6.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT paralajmërohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, (me emërtim të mëparshëm: SHTR RADIO PRO-FM SHPKNJP Gostivar), për shkeljen e kryer të nenit 15 paragrafi (5) të Ligji për media, në mënyrë që në afatin e parashikuar ligjor (31.3.2023) nuk ka dorëzuar në Agjenci raport me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen e transmetimit në radio, nr. 08-95, datë 5.1.2015, veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, as edhe informacion për mjetet teknike me të cilat transmetohet apo ritransmetohet shërbimi programor brenda dhe jashtë vendit.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është përcaktuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-1941/1 datë 27.4.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrjen administrative të veprimtarisë së botuesve të mediave nga aspekti i përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre me detyrimet e neneve 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullativ kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen në përputhje me rrethanat dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 15 paragrafi (5) nga LM, transmetuesit janë të detyruar organit rregullator kompetent t'i paraqesin raport me shkrim, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim në radio ose transmetim në televizion dhe veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, më së voni deri më 31 mars të vitit aktual. Në shtojcë të raportit dorëzohet edhe informacion për mjetet teknike nëpërmjet të cilit transmetohet ose ritransmetohet servisi i tyre programor në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit. Raporti me shkrim dorëzohet në formularin e përcaktuar nga organi rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektori për çështje programore, më 27.4.2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative, gjatë së cilës është konstatuar se SHTR RADIO PRO-FM SHPK

Gostivar në afatin e paraparë me ligj (31.3.2023) nuk ka dorëzuar në Agjencion raport me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim në radio, veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, as informacion për mjetet teknike me të cilat transmetohet apo ritransmetohet shërbimi programor në vend dhe jashtë tij, duke mos përmbushur kështu detyrimet e nenit 15 paragrafi (5) nga Ligji për Media.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-1941/1 datë 27.4.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar më datë 2.5.2023, dërgoi Shkresë me Nr.y në ark.10-1941/2 datë 5.2.2023. me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-1941/1 datë 27.4.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt më 25.5.2023 Në afatin e paraparë SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar nuk u deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 15.6.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim, konstatoi se ndaj SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar duhet t'i shqiptohet masë – vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (5) të LM, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-1941/1 datë 27.4.2023 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-2414/7 datë 15.6.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LM, përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur më 15.6.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar dhe detyrohet që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga data e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij botuesi i medias (transmetuesi) ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

**Shtojca (1):**

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark. nr. 10-1941/1 datë 27.4.2023.